



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.03-325**  
**17.10.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 92, paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Rregullores për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3332/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3637/10 datë 17.10.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në vazhdimin e parë të seancës së 32-të mbajtur më 16.10.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës – vërejtje publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, për shkeljen e kryer të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që radiodifuzeri në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 9-të gusht 2023, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, si dhe as gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, transmetuar në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3332/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostiver, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e vërtetimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 28 nga LSHMAAV është kompetente të kryej mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimit mediatik audiovizuel sipas kërkesës, si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të Ligjit në fjalë, lejeve, vërtetimeve të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – vërejtje publike në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar në lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 92, paragrafët (1) dhe (3) nga LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv, obligohen gjatë ditës të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio dhe audiovizuale maqedonase, ndërsa shërbimi publik radiodifuziv së paku 40%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv, obligohen së paku gjysmën e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni t'i realizojnë në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, me 31 gusht 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore, nga ku konstatoi se më 9 gusht 2023, në shërbimin programor televiziv të G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, është transmetuar 14 orë 30 minuta dhe 8 sekonda programë që hyjnë në llogaritjen për program të krijuar burimor, nga ku, aspak nuk ka transmetuar program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase (0.00%).

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3332/1 datë 01.09.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, me datë 01.09.2023, ka dërguar Shkresë ark.nr.10-3332/2 datë 01.09.2023, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3332/1 datë 01.09.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkeresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e radiodifuzerit më 11.09.2023. Në afatin e parashikuar, G-TV TELEVISIONI SHPKNJP Gostivar, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave nga Ligji. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 16.10.2023, pasi shqyrtoi Raportin me shkrim, konkludoi që G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar t'i shqiptoi masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92, paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas Aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3332/1 datë 01.09.2023, për konstatim të mos respektimit të dispozitave nga LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në vazhdimin e parë të seancës së 32-të mbajtur me datë 16.10.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-3637/10 datë 17.10.2023, miratoi Aktvendimin me të cilin publikisht paralajmërohet G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar dhe obligohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit. Pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24, paragrafët (1) dhe (2) nga LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3332/1 datë 01.09.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendim, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.